



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

Nr. _____ prot

Përmet më, _____._____.2026

PROCESVERBAL

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM PËR PROCEDURËN E PROKURIMIT PROCEDURE
E HAPUR -PUNË, PROKURIM ELEKTRONIK**

OBJEKTI I PROCEDURËS: Rehabilitimi i Kopshtit Nr. 1 Qytet Përmet

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
45214100-1 - Punime ndërtimi për kopështe femijësh

VLERA E FONDIT LIMIT:

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: **36 847 829,06** (tridhjetë e gjashtë milion e tetëqind e dyzetë e shtatë mijë e tetëqind e njëzetë e nëntë presje zero gjashtë) lekë pa TVSH i detajuar si më poshtë:

- Financimi nga Buxheti i Ministrisë së Arsimit për **vitin 2026** do të jetë në vlerën **6 264 130,8** (gjashtë milion e dyqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e njëqind e tridhjetë presje tetë) lekë pa TVSH, **për vitin 2027** do të jetë në vlerën **9 083 333,3** (nëntë milion e tetëdhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre presje tre) lekë pa TVSH dhe për **vitin 2028** do të jetë në vlerën **15 973 190,8** (pesëmbëdhjetë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e njëqind e nëntëdhjetë presje tetë) lekë pa TVSH.
- Financimi nga të ardhurat e Bashkisë **për vitin 2026** do të jetë në vlerën **5 527 174,16** (pesë milion e pesëqind e njëzetë e shtatë mijë e njëqind shtatëdhjetë e katër presje gjashtëmbëdhjetë) lekë pa TVSH.

Argumentimi:

Për përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, mbështetur në Ligjin Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, dhe VKM-në Nr 285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 76, sipas të cilit përcaktohet se në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë:

a) çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose/dhe

b) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim;
ose/dhe

- c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe
ç) çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.

Pas shqyrtimit të të dhënave teknike dhe informacionit të mbledhur të zërave të punimeve, rezultoi vlera e përgjithshme e kontratës. Çmimet e përdorura në preventiv janë në përputhje me çmimet e "Sistemit të integruar të manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim" i përcaktuar në pikën 2, të nenit 19, të VKM nr. 216, datë 13.04.2023 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim".

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar), autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Përmet** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;
b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP i ndryshuar, nenit 26 dhe 29 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1.Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Sipas kriterëve të përgjithshme të përzgjedhjes/ kualifikimit pika 1 e kësaj shtojce (Shtojca 7).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP i ndryshuar, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2023, 2024 dhe 2025** ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e e fondit limit të përlogaritur të kontratës që po prokurohet.

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP i ndryshuar, si dhe nenin 43, pika 2/b, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në **nenin 77 pika 3 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar** ku parashikohet se: *“Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën”, “Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar”, “Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës” si dhe bazuar në nenin 43, pika 2/b, nenin 47 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar ku parashikohet se: Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;*

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

Duke marrë në konsideratë vlerën e fondit limit të kësaj procedure prokurimi, kërkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për të realizuar atë në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar **duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të përlllogaritur të kontratës që prokurohet** dhe vendosja e këtij limiti nuk kufizon pjesëmarrjen e operatoreve ekonomike.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklarave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, si dhe Ligjin 9920 datë 19.05.2008, për Procedurën Tatimore, neni 64 Deklarata Tatimore. Kjo është një kërkesë e cila nuk e pengon konkurrencën dhe është e bazuar në garancinë që ofertuesi i paraqet Autoritetit Kontraktor.

Autoriteti Kontraktor në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaraten vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaraten vjetore në organet tatimore

*brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtënkohëbilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar nëudhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji,pasi tatimpaguesit (operatorët ekonomikë) kanë detyrimin të dorëzojnë në administratën tatimore brenda **datës 31 mars të vitit pasardhës** bilancin kontabël së bashku me anekset e tij, si dhe Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar në rastet kur plotësohen kushtet e parashikuara nga ligji.*

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të viteve: **2023, 2024 dhe 2025** të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. (Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP i ndryshuar, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në përputhje me ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c (Shënim: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës,

Ose

- b) Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, të jetë jo më e vogël se dyfishi i fondit limit të kontratës që prokurohet.

Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike, **Pika 2.3.1/a** plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse **pika 2.3.1/b** duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kontratë Sipërmarrje
- Situacionin përfundimtar
- Akt i kolaudimit
- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9;

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kontratë Sipërmarrje;
- Situacion/faturë tatimore të deklaruar në organet tatimore;
- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9;
- Dhe çdo lloj dokumenti tjetër që provon realizimin me sukses të punëve;

-Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën e bashkimit të operatorëve dhe Prokurën e posaçme, të deklaruar në fazën e tenderimit.

-Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën baze ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin nga ana e Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 40 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose minimalisht sa dyfishi i fondit limit, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Për kontratat e realizuara si bashkim operatorësh, operatorit ekonomik ofertues i është kërkuar edhe paraqitja e kontratës së bashkimit të operatorëve shoqëruar me tabelën e ndarjes së

punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsipër të kryejë secili anëtar i BOE – së, mbështetur në parashikimet e nenit 88 të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar. Me anë të këtij dokumentacioni AK ka mundësi të njihet me vlerën reale të punimeve të realizuara nga ofertuesi/t, mbi bazën e një kontrate të realizuar si BOE.

Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor është kërkuar edhe miratimi nga ana e autoritetit kontraktor, si nënkontraktor i deklaruar, në respektim të parashikimeve të nenit 89 të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Pra, dokumentacioni i kërkuar si më sipër, është kërkuar me qëllim që AK të përllogarisë vlerën e saktë të kontratave të mëparshme të realizuara nga ofertuesi, brenda afatit të përcaktuar në pikën 2.3.1, shkronja a) dhe b).

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, sipas formatit të miratuar me *Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhenies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi"* i ndryshuar e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit:

- **N.P-1 A** Punime gjurmimi në tokë;
- **N.P -2 A** Ndërtime civile dhe industriale;
- **N.P-3 A** Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash;

Për punimet speciale të ndërtimit:

- **N.S-1 A** Punime për prishjen e ndërtimeve;
- **N.S-2 A** Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre;
- **N.S-4 B** Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese;
- **N.S-12 A** Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit;
- **N.S-14 A** Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV;

Shënim: Në rastet e mbështetjes në Kapacitete të subjekteve të tjera/Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, secili anëtar i bashkimit duhet t'i disponojë në raport me zërat, përqindjen e marrë përsipër, sipas angazhimit me shkrim/ kontratën e bashkëpunimit. Mosparaqitja në këto forme është kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, si dhe Vendim nr.42, datë 16.1.2008 "Për miratimin e rregullores, për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", i ndryshuar lidhja 2,3 dhe 4.

Të dhënat për liçencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit Nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar, ku neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj të pajisur me licencën përkatëse për zbatim punimesh ndërtimi.

Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane. Lidhur me nivelin e kategorive në liçencë janë në përputhje me natyrën dhe fondin limit që prokurohet, si dhe kërkohet që operatorët ekonomikë të japin garanci që i kanë aftësitë tekniko – profesionale në nivele të kategorive për realizimin e objektit që prokurohet.

Konkretisht:

Llojet e licencave dhe klasifikimi i tyre, sipas kategorive dhe niveleve (gërmave) përkatëse janë bërë në përputhje me natyrën e punimeve respektive dhe vlerën e përlllogaritur sipas preventivit të hartuar për këtë objekt.

Kategoria e kërkuar	Përshkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP – 1	Punime gërmimi në tokë	Zërat me nr. rendor 35,36,37,38,39	A (0 – 20 milion lekë)	152 894,61
NP – 2	Ndërtime civile dhe industriale	Zërat me nr. rendor 75,76,77,78,122,123	A (0 – 20 milion lekë)	788 229,14
NP – 3	Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash	Zërat me nr. rendor 43,44,45	A (0 – 20 milion lekë)	187 602,51
NS – 1	Punime për prishjen e ndërtimeve	Zërat me nr. rendor 1,2,3,4,5,6,7,8,9,10,11	A (0 – 20 milion lekë)	2 348 072,12
NS – 2	Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre	Zërat me nr. rendor 51,52,53,54,55,56, 57,58,59,60,61,62, 63,64,118,119,120,121	A (0 – 20 milion lekë)	881 328
NS – 4	Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese	Zërat me nr. rendor 12,13,14,15,16,17, 18,19,20,21,22, 23,24,25,26,27, 28,29,30,31,32,33,34, 40,41,42,46,47,48,49,50, 65,66,67,68,69,70,71,72, 73,74,79,80,81,82	B (21 – 50 milion lekë)	26 292 298,83

NS – 12	Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit;	Zërat me nr. rendor 124,125,126,127, 128,129,130, 131,132,133,134, 135,136,137,138, 139,140,141,142, 143,144,145	A (0 – 20 milion lekë)	2 920 592,11
NS – 14	Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV	Zërat me nr. rendor 83,84,85,86,87,88,89,90 91,92,93,94,95,96,97,98 99,100,101,102,103,104 105,106,107,108,109,110 111,112,113,114,115 116,117	A (0 – 20 milion lekë)	1 522 153,21

Këtu nuk përfshihet fondi rezervë prej 5%.

2.3.3 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar personelin kryesor **drejtues teknik te perfshire ne licensen e shoqerise**, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplome universitare, librezë pune si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, konkretisht:

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi

(Në rastin e Bashkimit të Operatoreve Ekonomik secili Operator duhet të përcaktojë me anë të një deklarate Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera).

Shënim: Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “..... Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Argumentimi:

Së pari, kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Së dyti, duke qenë se objekt prokurimi është kontratë pune sqarojmë se detyrimin për prezencën e Drejtuesit Teknik gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt e përcakton qartazi Udhëzimi Nr.2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, konkretisht pika 1.2 ku citohet se: “drejtuesit ligjore dhe teknik të sipërmarrësit janë përgjegjës përpara investitorit për ndërtimin e veprës, sipas projektit, për kryerjen e punimeve të ndërtimit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë, brenda kushteve

të kontratës e dispozitave ligjore në fuqi” si dhe pikës 2.1 ku citohet se “drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejtë nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit.

Lidhur me kërkesën që Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të mos jetë i angazhuar në kontrata të tjera, mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohet se: “Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohej të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit” dhe pika 2: “elementët e licensës” germa “c” ku citohet se: “Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKR apo gjykatë. Ndalohej ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”.

Për sa më lart, çdo kërkesë e renditur për Drejtuesin Teknik, buron nga kontrata e punës objekt prokurimi, me qëllim përmbushjen dhe realizimin e saj sipas kushteve dhe dispozitave ligjore në fuqi.

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Numri dhe formimi profesional i inxhinierëve që përbëjnë stafin kryesor teknik, është përcaktuar duke u nisur nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve.

Kjo kërkesë është përcaktuar pas analizimit që i është bërë preventivit të punimeve (nga ku përcaktohet edhe profili inxhinierik) si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në licencën profesionale të shoqërisë. Duke parë dhe marrë në konsideratë kompleksitetin e punimeve që do të realizohen, referuar këtu projekt-preventivit të zbatimit, është e domosdoshme që çdo ofertues të ketë pjesë të stafit të tij, inxhinierët e kërkuar në këtë pikë, të cilët në bashkëpunim me njëri-tjetrin si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht **18(tetëmbëdhjetë) punonjës** të pasqyruar në listëpagesen e muajit të fundit. Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve muajin e fundit.
- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për muajin e fundit.

(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike pikat e kriterit 2.3.4 duhet të plotësohen nga secili anëtar i bashkimit, në përputhje me natyrën e punimeve dhe përqindjen e pjesëmarrjes në punë, të përcaktuara në akt marrëveshje).

Shënim: Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “..... Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit 77, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/ç), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për realizimin me sukses të kontratës.

Konkretisht, në përcaktimin e numrit të punonjësve që duhet të ketë shoqëria ofertuese, janë analizuar dhe janë marrë në konsideratë volumet, orët e punës, zërat, kategoritë dhe kompleksiteti i punimeve, kualifikimi i punonjësve (ku përfshihet stafit organizativ, administrativ, tekniko-inxhinierik dhe ai mbështetës), grafiku i punimeve dhe shpërndarja e kantierit etj. Vendosja e këtij kriteri është teknikisht i argumentuar, pasi i përgjigjet përmasave të kontratës që prokurohet si për nga fondi limit, kohështirja, por edhe për nga natyra e punimeve duke marrë në analizë manualin teknik të punimeve të ndërtimit në fuqi.

Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështirje minimalisht muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, tregon besueshmërinë e nevojshme për autoritetin kontraktor lidhur me përmbushjen e kontratës nga OE. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të Operatorit Ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është detyrim i punëdhënësit sipas parashikimeve të legjislacionit të fushës dhe Kodit të Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarëve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat e kualifikimit, përveç besueshmërisë së Operatorëve Ekonomikë, përpiket të kufizojë edhe

problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, dhe njëkohësisht është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës së punonjësve.

Gjithashtu për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore si dhe stabilitetin e saj është kërkuar edhe vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore si dhe listëpagesat e punonjësve, mbështetur në Kreun V, Seksioni III, Neni 39, pika 8, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar sipas së cilës: “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

Kriteri për kualifikim është vendosur që t’i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Nr	KODI	EMËRTIMI I PUNIMEVE	NJËSIA	SASIA	Ore pune/njesi	Ore pune puntori total	Ore pune makineri	Ore pune makineri total
		1. PRISHJE						
1	2.426/3	Prishje shtresa betoni	m3	2.2	18.8	41.36		
2	2.426/12	Prishje suvatim solete (h<4m)	m2	463.5	1.71	792.585		
3	2.430/1	Prishje mur guri	m3	0.8	6.6	5.28		
4	2.426/1	Prishje mur tulle me pastrim	m3	7.2	6.2	44.64		
5	2.426/9	Prishje suvatim i jashtem	m2	712	1.308	931.296		
6	2.426/11	Prishje suvatim muri i brendshem	m2	1310	0.93	1218.3		
7	2.405/1	Prishja e davancaleve ekzistuese (dritareve) + korimano shkallesh	m2	12.5	0.26	3.25		
8	2.430	Prishje shtrese lluster-çimento dyshemeje	m2	219	0.396	86.724		
9	2.426/7	Prishje kollona, trare b/a	m3	0.05	35.2	1.76		
10	2.197/1	Prishje e hidroizolimit ekzistues (terrace)	m2	370	0.5	185		
11	2.426/3	Prishje shtresa betoni	m3	30	18.8	564		
		SHUMA 1:						
		2. PUNIME DYER DRITARE						
12	2.391	Heqje dyer ekzistuese	m2	130	1.2	156		
13	2.608	Heqje dyersh me kangjella metalike	m2	45	1.56	70.2		
14	2.375/1	F.V. Dritare d/alumini plastike me dopio xham	m2	48.6	2.65	128.79		
15	2.388	Dyer druri zd kd 1/2 xham	m2	3.65	2	7.3		
16	2.390/1	F.V. Dyer metalike llamarine	m2	3	2.4	7.2		
17	2.395/1	F.V. Dyer d/alumini plastike me dopio xham	m2	22.9	2.67	61.143		
18	2.388/1	F.V. Dyer te brendeshme tamburate te rimesuara	m2	57.6	2	115.2		
		SHUMA 2:						
		3. PUNIME SHITESASH 2						
19	2.281/5	Heqje pllakash majolike	m2	106	2.22	235.32		
20	2.263	Heqje dysheme druri (binare druri + derrase + parket)	m2	140	1.32	184.8		
21	2.264	Shtrese lluster cemento 1:2	m2	305	0.66	201.3	0.03	9.15
22	2.266	Shtrese me pllaka granili te zakonshme, 30x30cm	m2	370	1.54	569.8	0.07	25.9
23	2.264	Shtrese lluster cemento 1:2	m2	325	0.66	214.5	0.03	9.75
24	2.276	Shtrese parketi	m2	140	4.7	658	0.12	16.8
25	2.697	Rrashnim parketi	m2	140	2.5	350	0.41	57.4
26	2.267/1	Shtrese me pllaka porcelanat	m2	210	2	420	0.02	4.2

27	2.273/5	Shtrese me pllaka mermeri t=3cm	m2	38.5	3.12	120.12	0.02	0.77
28	2.273/4	Shtrese me pllaka mermeri t=2cm	m2	14	3.12	43.68	0.02	0.28
29	2.261	Shtrese rere	m3	20	2.175	43.5		
		SHUMA 3:						
		4. PUNIME HIDROIZOLIMI DHE ÇATITE						
30	2.208/2	Heqje ulluk shkarkimi horizontal me llamarine xingato	ml	159	0.78	124.02		
31	2.203	Veshje kornize llamarine xingat	m2	50	1.6	80		
32	2.209	Ulluk shkarkimi vertikal me llamarine xingat Ø 100	ml	53	1.09	57.77		
33	2.212	Ulluk shkarkimi horizontal me llamarine xingat 33cm	ml	8	1.3	10.4		
34	2.196/b	Hidroizolim me nje shtres astar me baze cimento. Pergatitur nga dy komponente A+B	m2	325	0.42	136.5	0.04	13
		SHUMA 4:						
		5. PUNIME DHEU						
35	2.37/5b	Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 10.0 km	m3	142	0.21	29.82		
36	2.5	Germim e mbushje dheu me krah kat III per themele, h=1.5m	m3	13	4.15	53.95		
37	2.37/5b	Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 10.0 km	m3	35	0.21	7.35		
38	2.5	Germim e mbushje dheu me krah kat III per themele, h=1.5m	m3	5.71	4.15	23.6965		
39	2.37/5b	Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 10.0 km	m3	51	0.21	10.71		
		SHUMA 5:						
		6. PUNIME MURATURE TULLE						
40	2.70/2	Mur me tulla te lehtesuara deri - 3 m, LL.P. M-25	m3	4	15.7	62.8	0.55	2.2
41	2.96/b	Veshje muri me MDF	m2	16	2.8	44.8		
42	2.70/2	Mur me tulla te lehtesuara deri - 3 m, LL.P. M-25	m3	18	2.8	50.4		
		SHUMA 6:						
		7. PUNIME BETONI DHE B/A						
43	2,121	Breza b/a monolit C 16/20	m3	0.15	18.76	2.814	2.7	0.405
44	2,109	Themel e xokol betoni C 12/15	m3	9.7	8.54	82.838	0.9	8.73
		SHUMA 7:						
		8. PUNIME HEKUR BETONI						
45	2.166	F.V. Hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm	ton	0.15	60	9	0.63	0.0945
		SHUMA 8:						
		9. PUNIME BOJATISJE						
46	2.422 / 1	Termoizolim tavani 20 cm me piaterme	m2	305	10.2	3111		
47	2.413	F.V. Zgara dekorativa hekuri mesatare	ton	1.5	54.6	81.9		
48	2.404/1	Boje hidroplastike cilesi e larte	m2	1774	0.36	638.64		
49	2.415	F.V. Porte metalike dekorative rreshqitese	m2	15.5	2.46	38.13	0.18	2.79
50	2.413	F.V. Zgara dekorativa hekuri mesatare	ton	2.25	54.6	122.85		
		SHUMA 9:						
		10. INSTALIME HIDRO-SANTARE DHE NGROHJE						
51	2.515	F.V. Pilete dysHEMEJE Ø 50	copë	8	1.7	13.6		
52	2.494/5	F.V. Saracineska bronzi Ø 2 " = 50 mm	copë	3	1.47	4.41		
53	2.491/e	F.V. Tuba e rakorderi ujesjellesi PE d=50mm, Pn 16	ml	20	0.3	6		

54	2.535/g	Termoizolim tubi Ø 2" me armofleks (d64x9)	ml	20	0.1	2		
55	2.491/a	F.V. Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=20~25mm, Pn 25	ml	85	0.3	25.5		
56	2.501	F.V. WC allafrenga	copë	7	3.7	25.9		
57	2.508	F.V. Bolier 100 l	copë	6	2.1	12.6		
58	2.494	F.V. Saracineska bronzi Ø 1/2 " = 15 mm	copë	1	1.2	1.2		
59	2.495	F.V. Lavaman porcelani	copë	9	2.95	26.55		
60	2.217	F.V. Bolier 12 liter, uje te ngrohte sanitar	copë	6	4.5	27	0.5	3
61	2.520	F.V. Tub kanalizimi pvc Ø 110	ml	30	1.43	42.9		
62	2.519	F.V. Tub kanalizimi pvc Ø 90	ml	35	1.43	50.05		
63	2.515	F.V. Pilete dyshejeje Ø 50	copë	3	1.7	5.1		
64	2.523	F.V. Tub kanalizimi pvc Ø 200	ml	65	1.9	123.5		
		SHUMA 10:						
